



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 872/ prot.

Tiranë, më 20.09.2024

N J O F T I M

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”, i ndryshuar, Statutit dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin për pozicionin e punës “Pianist Korepetitor” pranë Drejtorisë së Baletit.**

Për t’i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune dhe për t’i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të personave të interesuar, TKOBAP-ja publikon njoftimin e saj ditën e sotme.

Audicioni do të zhvillohet në **datën 21.10.2024, ora 12:30, në Sallën e baletit** të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Personat e interesuar duhet të plotësojnë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për pozicionin e punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje të certifikuar nga shteti i tij;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;
7. Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja (preferohet anglisht).

Të gjithë personat e interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP-së deri në datën 14.10.2024, ora 16:30 ose në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri në orën 00:00 me objekt: Aplikim për pozicionin e punës “Pianist Korepetitor” pranë Drejtorisë së Baletit.

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur
2. Jetëshkrimi (CV)
3. Fotokopje të mjetit të identifikimit
4. Diploma, suplementi dhe lista e notave të noterizuara në nivelin Master. Nëse aktualisht jeni në përfundim të studimeve të larta në nivelin Master për piano, të depozitohet diploma Bachelor dhe lista e notave të noterizuara dhe një vërtetim se jeni në përfundim të studimeve. Në rast se arsimimi është kryer jashtë vendit, të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, tituj artistikë, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e aplikantit
6. Libreza e punës e noterizuar ose vërtetim mbi pagesën e kontributeve
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e dokumenteve sjell skualifikimin e aplikantit.

Pas verifikimit të dokumentave të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.

***Programi për konkurimin është interpretimi (përzgjedhja për interpretimin nga kandidatët do të bëhet nga Komisioni i Vlerësimit) nga veprat e mëposhtme:**

1. Baleti "Arrëthyesi", Akti 2
2. Baleti "Liqeni i Mjellmave", Akti 3
3. Opera "Aida", numrat koreografike në "Gran Finale Secondo"
4. Një pjesë pianistike solistike deri në 10 (dhjetë) minuta
5. Shoqërim i ushtrimeve të baletit të kërkuara nga komisioni
6. Provë e kulturës së përgjithshme në lidhje me literaturën koreografike në përgjithësi dhe veprat që janë subjekt i audicionit në veçanti.

Shënim: Komisioni ruan të drejtën të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit si më lart.

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem të na kontaktoni në adresën elektronike:
sekretaria@tkob.gov.al.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Abigeila Voshfina



Adresa: Sheshi "Skënderbej", Pallati i Kulturës, Tiranë

www.tkob.gov.al